

**BASHKIA TEPELENË**  
NJOFTIM PËR DHËNIEN ME QIRA

Në zbatim të VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Per transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve e kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/bashkive” të ndryshuar; Udhezimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.6.2016 “Per rregullat e procedurat e kerkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullor publik”; VKB nr.30 datë 30.04.2021, VKB nr.21 datë 23.02.2023 dhe VKB nr.38 datë 29.03.2023 “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor ndodhur në Bashkinë Tepelenë”, të sipërfaqes së llojit “Pyll” me numër pasurie 812 ZK 1913 me sipërfaqe 28.72 ha, pasuria e llojit “Kullotë” nr.907 ZK 1913 me sipërfaqe 6.33 ha, dhe pasuria e llojit “Kullotë” nr.410 ZK3177 me sipërfaqe 3.59 ha, sipas certifikatës së pasurisë në pronësi të Bashkisë Tepelene, ndodhur në Njesinë Administrative Kurvelesh, Bashkia Tepelene:

## NJOFTIM:

- Fillimin e procedurave te dhenies me qira te llojit “Pyll” me numer pasurie 812 ZK 1913 me siperfaqe 28.72 ha, ndodhur ne Njesine Administrative Kurvelesh/Bashkia Tepelene.
- Fillimin e procedurave te dhenies me qira te llojit “Kullote” me numer pasurie 907 ZK 1913 me siperfaqe 6.33 ha, ndodhur ne Njesine Administrative Kurvelesh/ Bashkia Tepelene.
- Fillimin e procedurave te dhenies me qira te llojit “Kullote” me numer pasurie 410 ZK 3177 me siperfaqe 3.59 ha, ndodhur ne Njesine Administrative Kurvelesh/ Bashkia Tepelene.
- Qellimi i perdorimit do te jete per “Agropylltari”.
- Cmimi dysheme do te jete ne zbatim te VKM nr.559 date 29.07.2022 “Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore e jodrusore pyjore”, duke filluar nga 10\*000 (dhjete mije) leke/ha/vit .
- Afati i kontrates se qerese eshte deri ne 10 vjet.
- Vleresimi i konkurrenteve do te behet sipas ketyre pikave:
  - Projekti teknik i veprimtarise qe do te ushtrohet i cili permban hartem topografike me koordinatat e siperfaqes objekt perdorimi ne variantin pdf. dhe format elektronik ne shkalle 1:10000 ku jane evidentuar elemente kryesore si: kufijte natyrore, relieve, objekte aktuale, si dhe cdo planimetri tjeter ne shkalle me te detajuar, hartuar konform kerkesave.....30 pike.
  - Plani i biznesit dhe investimet.....20 pike.
  - Niveli i punesimit.....10 pike.
  - Masa e qirase per ha/vit.....40 pike.
- Terheqja e dokumentacionit te nevojshem do te behet prane Bashkise Tepelene.
- Paraqitja e dokumentacionit do te behet ne daten 06.11.2023 ora 10:00 ne zyren e protokollit te Bashkise Tepelene dhe konkurimi do te vijoje ne sallën e mbledhjeve.
- Dokumentacioni qe duhet te plotesohet nga konkurrentet per konkurrim eshte:
  - a) kerkesen e operatorit se bashku me gjeneralitetet e tyre.
  - b) Ekstraktin e regjistrimit ne QKB per objektin e veprimtarise.
  - c) Projektin teknik te hartuar nga specialist te licencuar ku jane trajtuar te gjithë elementet e nevojshem per zhvillimin e veprimtarise se kerkuar.
  - d) planbisnesin e hollesishem , ku te pershkruhen qarte:
    - i)plani i punesimit, ndikimi i tij rritjen e te punesuarve.
    - ii) plani i investimeve, si dhe treguesit qe do te realizohen.
  - e) Te dhenat per kapacitetet teknike, stafin, makineri qe zoteron.
  - f) Planin e rehabilitimit te siperfaqes dhe kthimin e saj ne gjendjen e meparshme.
  - g) Oferten e detyrimit mujor te qirase.
  - h) Certifikaten e regjistrimit dhe ekstraktin historik te regjistrimit ne QKB te subjektit.
  - i) NUIS/NIPT dhe vertetimin nga dega e tatimeve se subjekti nuk ka detyrime tatimore.
  - j) Vertetim nga institucionet perkatese se nuk eshte ne ndjekje penale dhe nuk ka proces gjyqesor qe lidhet me veprimtarine qe ushtron.

- k) Leje mjedisore per aktivitetin e kerkuar, (raport i ndikimit ne mjedis i perfshire ne planin e rehabilitimit).
- l) Vertetimin nga sektori i tatimeve Bashkia Tepelene se subjekti nuk ka detyrime tatimore.
- m) Garanci te mjaftueshme me perballimin e investimit te parashikuar ne planbiznesin e dorezuar (vertetim nga banka).
- n) Deklarata mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme

Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti, ose te dokumenteve te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per shkualifikim.